

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.A.

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i prokurimit	NP Termokos.sha-25-11508-1-2-1
Nr i brendshëm	TER-025-018-1.2.1.

Sa i përket tenderit për: Furnizim me Module për PLC-Prodhim -Ritender II

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Emri i Kompanisë: **Botek shpk**

Adresa : **rr. Agim Ramadani, nr 517. 10 000 Prishtinë**

Numri Telefonit/ Numri i Faks-it:

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj: **Hilmi Asllani**

Adresa elektronike: hilmi.asllani@bo-tek.com

Data e parashtrimit të ankesës: **20.08.2026**

Nënshkrimi dhe vula:



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë “apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftim për kontratë, datë 14.05.2026
- Afati i fundit për dorëzim të ofertave, datë: 08.06.2026, ora 13:30.
- B58 Njoftimi mbi vendimin e AK, datë: 04.08.2026
- Qasje në dokumente, datë: 06.08.2026
- Kërkesa për Rishqyrtim, datë: 10.08.2026
- Përgjigja nga AK në Kërkesën për Rishqyrtim, datë: 13.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Nuk aplikohet

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëturjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

- Kërkesa për Rishqyrtim, datë: 10.08.2026
- Vendimi i Autoritetit Kontraktues mbi Kërkesën për Rishqyrtim, datë: 13.08.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 i LPP Nr. 04/L-042 - Barazia, Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 28 i LPP Nr. 04/L-042- Specifikimet teknike
Neni 59 i LPP Nr. 04/L-042- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
Neni 69 i LPP Nr. 04/L-042 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Shkeljet e dispozitave - **UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK**

Pika 5 e Udhëzuesit: Specifikimet Teknike

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Përmes kësaj ankese, atakojmë Vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me refuzimin e Kërkesës sonë për Rishqyrtim. Pretendimet e paraqitura nga ana jonë kanë qenë të qarta, të argumentuara dhe të mbështetura si në prova materiale, ashtu edhe në bazë të dispozitave përkatëse ligjore.

Megjithatë, nga mënyra se si Autoriteti Kontraktues – Termokos e ka trajtuar Kërkesën tonë për Rishqyrtim, rezulton se nuk është bërë një shqyrtim i mirëfilltë dhe objektiv i pretendimeve tona, duke dëshmuar edhe një herë mangësi në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave në përputhje me kërkesat e dokumentacionit të tenderit dhe legjislacionit në fuqi.

Për të paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë pretendimet tona, të cilat nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtë nga Autoriteti Kontraktues, ato i paraqesim si në vijim:

I. LIDHUR ME OFERTËN E OE “E&J KOCI” SHPK

OE E&J Koci SHPK, i propozuar për dhënie të kontratës, nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit për këto arsye:

1. Mosplotësimi i kërkesës lidhur me listën e kontratave të ngjashme

Në Dosjen e Tenderit është përcaktuar shprehimisht kërkesa që OE të dorëzojë: ***“Listën e kontratave që specifikon furnizimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin, duke i bashkëngjitur dëshmitë përcjella me certificate të livrimit-dorëzimit të mirë (kopje) ose referencë (kopje), për furnizime, të nënshkruara nga pranuesi i furnizimeve për kontratat e cekura në listë.”***

Megjithatë, nga dokumentacioni i dorëzuar nga OE E&J Koci SHPK rezulton se në listën e kontratave të paraqitura nuk janë specifikuar furnizimet e realizuara në kuadër të kontratave të referuara.

Kjo është me rëndësi thelbësore për vlerësimin e përmbushjes së kërkesës për përvojë teknike dhe profesionale, pasi nuk mjafton vetëm ekzistenca e një kontrate apo reference; duhet të jetë e mundur të verifikohet në mënyrë objektive se çfarë furnizimesh janë realizuar, në çfarë vlere, kur janë realizuar dhe nëse ato përputhen me kërkesën e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Në mungesë të këtij informacioni, Autoriteti Kontraktues nuk ka bazë të mjaftueshme dokumentare për të konstatuar se kontratat e paraqitura nga ky OE përmbushin kërkesën konkrete të FDT-së për përvojën e ngjashme.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se kjo ofertë nuk mund të konsiderohet e përgjegjshme pa u dëshmuar në mënyrë të qartë dhe të verifikueshme përmbushja e kërkesës së përcaktuar në FDT.

Prova 1: Lista e kontratave e dorëzuar nga OE i propozuar për kontratë

Sipas AK, në përgjigjen e tyre mbi Kërkesën për Rishqyrtim, OE E&J Koci shpk, për këtë pretendim është përgjigjur thukët se, cit: ***“Gjatë vlerësimit të ofertave komisioni i vlerësimit ka vlersuar të gjitha ofertat e pranuar dhe ka konstatuar se oferta e O.E E & J Koci shpk është oferta me qmimin më të lirë të ofruar i cili i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara. O.E fitues E & J Koci shpk në ofertën e tij ka prezentuar listën e kontratave dhe referencën e natyrës së ngjashme gjeni bashkëngjitur më poshtë:.”*** Dhe këtu AK ka bashkëngjitur listën e referencave (e cila nuk përmbush kriterin e FDT, pasi mungojnë pajisjet e furnizuara) dhe një referencë me titull: ***“Paisje testuese për mirëmbajtjen e sistemeve – Ritender”***

Është e paqartë se si AK, vetëm mbi bazën e titullit të kontratës, ka arritur në përfundimin se OE e ka përmbushur këtë kërkesë, pasi që nga vetë titulli nuk mund të përcaktohet se cilat pajisje janë furnizuar në kuadër të kontratës. Pajisjet e furnizuara mund të jenë, për shembull, multimetra, megometra, testues të tensionit apo pajisje të tjera të përgjithshme elektrike, të cilat nuk kanë lidhje me automatizimin dhe kontrollin industrial, e aq më pak me pajisjet konkrete të kërkuara në këtë procedurë, përkatësisht modulet CPU për PLC, ndërprerësit industrialë Ethernet, pajisjet e komunikimit industrial në distancë dhe modulet e furnizimit me energji elektrike.

Rrjedhimisht, në mungesë të listës së pajisjeve të furnizuara dhe dokumentacionit përkatës që dëshmon natyrën dhe përmbajtjen e furnizimeve, nuk mund të konstatohet në mënyrë të arsyetuar se kontrata e paraqitur është e ngjashme me objektin e këtij prokurimi.

2. Nuk është dorëzuar Deklaratë mbi specifikimet teknike

- Pas qasjes në dokumentet e dorëzuara të OE të propozuar për kontratë, kemi vërejtur se ky OE nuk ka dorëzuar fare Deklaratë mbi specifikimet teknike, sikurse kërkohet me LPP dhe rregullore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE E&J Koci SHPK, rezulton se dokumenti i kërkuar si Deklaratë mbi Specifikacionet Teknike nuk është dorëzuar.

Kjo nuk paraqet thjesht mungesë të një dokumenti dytësor, por mungesë të një dokumenti të kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit, LPP dhe rregullore, e i cili ka për qëllim t'i mundësojë Autoritetit Kontraktues verifikimin e qartë të pajtueshmërisë së mallrave të ofruara me specifikimet teknike të detyrueshme.

Në këtë drejtim, Neni 69 i LPP-së, së bashku me Udhëzuesin Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, përcakton rëndësinë e specifikimeve teknike dhe mënyrën e vlerësimit të përputhshmërisë së mallrave të ofruara me kërkesat e Autoritetit Kontraktues. Udhëzuesi Nr. 001/2023 parasheh, ndër të tjera, **se kur mungon specifikimi teknik për mallrat e ofruara, në rrethanat e përcaktuara në udhëzues, tenderi refuzohet pa kërkuar informacion të mëtejshëm.**

Për rrjedhojë, konsiderojmë se mungesa e dokumentit të kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit, si dhe të paraparë nga LPP-ja dhe Rregullorja në fuqi, e bën ofertën të papërgjegjshme dhe duhet të rezultojë në eliminimin e saj nga procedura e mëtejshme e vlerësimit.

Në këtë drejtim, mbetet e paqartë se si Autoriteti Kontraktues ka mundur të kryejë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të Operatorëve Ekonomikë pa pasur në dispozicion një specifikim të detajuar të produkteve të ofruara dhe dokumentacionin që dëshmon përputhjen e tyre me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Për më tepër, në përgjigjen e tij ndaj Kërkesës sonë për Rishqyrtim, AK-ja deklaron, citojmë: “Në Dosje të Tenderit dhe në Njoftim për Kontrat nuk është kërkuar si kriter në të cilin ju pretendon.”

Ky konstatim është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me vetë Dosjen e Tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktues. Konkretisht, në kuadër të FDT-së është përcaktuar shprehimisht se:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.”

Pra, kërkesa për paraqitjen e deklaratës mbi specifikimet teknike nuk është një kërkesë e pretenduar nga ana jonë, por një kërkesë e përcaktuar shprehimisht nga vetë Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit. Për këtë arsye, mosmarrja në konsideratë e mungesës së këtij dokumenti gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertës së OE-së përbën mospërputhje me kërkesat e detyrueshme të Dosjes së Tenderit dhe me dispozitat përkatëse të LPP-së dhe Rregullores në fuqi.

Fakti që Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen ndaj Kërkesës sonë për Rishqyrtim, nuk i ka dhënë rëndësinë e duhur këtij pretendimi dhe mungesës së Deklaratës mbi Specifikimet Teknike, përkundrazi duke mohuar ekzistencën e vetë kërkesës në Dosjen e Tenderit, dëshmon se procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk është zhvilluar me rigorozitetin dhe objektivitetin e kërkuar nga legjislacioni i prokurimit publik.

Shënim me rëndësi: për çështje të njejtë, (mungesë të Deklaratës mbi specifikimet teknike) ne kemi bërë dhe më herët ankesa, dhe nga Paneli Shqyrtues i ankesave janë vlerësuar si të bazuara.

Prova 2_Vendimi PSH nr 214/22; Vendimi PSH nr 258/22
Prova 3_Dosja e Tenderit

Lidhur me pretendimet tona të paraqitura më poshtë, Autoriteti Kontraktues është përgjigjur në mënyrë të përgjithshme dhe pa trajtim konkret të tyre, duke deklaruar, citojmë: *Pretendimet 3,4 dhe 5: Lidhur me pretendimet për Operatorit pjesmarrës në këtë Aktivitet të Prokurimit nuk janë shpallur fitues.*

Një arsyetim i tillë nuk adreson thelbin e pretendimeve tona dhe, përkundrazi, dëshmon edhe një herë se Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë një ekzaminim, vlerësim dhe krahasim të plotë e të drejtë të ofertave të paraqitura.

Fakti që Operatorët Ekonomikë në fjalë nuk janë shpallur fitues nuk i bën pretendimet tona të parëndësishme. Edhe Operatorët e tjerë pjesëmarrës, të cilët kanë paraqitur oferta me vlerë më të lartë, por brenda buxhetit të paraparë, duhet të jenë subjekt i verifikimit të përmbushjes së të gjitha kërkesave administrative dhe profesionale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Nëse një Operator Ekonomik nuk i përmbush këto kërkesa, ai nuk mund të trajtohet thjesht si “jo i suksesshëm”, por duhet të konstatohet si i papërgjegjshëm dhe të eliminohet nga procedura e prokurimit.

Për më tepër, një vlerësim i tillë është i domosdoshëm për të siguruar që vetëm ofertat e përgjegjshme të marrin pjesë në fazat përkatëse të vlerësimit dhe se renditja përfundimtare e ofertave bazohet në operatorë që i kanë përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Për këtë arsye, në vijim paraqesim pretendimet tona të faktuara, përmes të cilave dëshmohet se edhe Operatorët e tjerë Ekonomikë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit nuk i kanë përmbushur kërkesat administrative të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe, për rrjedhojë, duhej të ishin shpallur **të papërgjegjshëm dhe të eliminoheshin nga procedura e prokurimit.**

II. LIDHUR ME OFERTËN E OE NSH “BF ENERGY”

OE NSH “BF Energy”, i cili sipas çmimit të ofertës renditet i dyti, nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

1. Mospërmbushja e kërkesës për përvojën e ngjashme

Sikurse OE i propozuar për kontratë, edhe OE NSH “BF Energy” nuk ka specifikuar në mënyrë të qartë në listën e kontratave se çfarë furnizimesh janë realizuar në kuadër të kontratave të paraqitura.

Prova 4_Lista e kontratave të dorëzuar nga OE NSH BF Energy

Për më tepër, disa nga referencat e dorëzuara i përkasin periudhave që tejkalojnë periudhën prej tre (3) viteve të fundit, e cila është përcaktuar si periudhë relevante në kërkesat e FDT-së.

Ndërsa, sa u përket referencave që bien brenda periudhës së kërkuar, mungesa e specifikimit të furnizimeve në listën e kontratave e pamundëson verifikimin nëse ato kontrata përmbajnë furnizime të ngjashme me objektin e këtij aktiviteti.

Për shembull, është paraqitur projekti me titull: “Furnizim me pajisje dhe elemente për mirëmbajtjen e nënstacioneve (KOSTT)”. Kjo referencë sugjeron diçka tjetër nga natyra e vet — pajisje/materiale për mirëmbajtjen e nënstacioneve elektrike të tensionit të lartë (kjo zakonisht përfshin izolatorë, çelësa, pajisje mbrojtëse, materiale elektrike të NS-ve, e ngjashme) — jo domosdo module PLC-je apo matës ultrasonik energjie termike. Dallimi në domenin teknik është i madh dhe si rrjedhojë nuk kanë ngjashmëri siq është secifikuar ne kerkesat e DT (automatizim/instrumentacion vs. mirëmbajtje elektrike e nënstacioneve HV)

Autoriteti Kontraktues, gjatë vlerësimit, duhet të jetë në gjendje të verifikojë në mënyrë objektive dhe të dokumentuar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në FDT dhe jo të mbështetet vetëm në titullin e përgjithshëm të një kontrate apo reference.

2. Mungesa e Deklaratës së kërkuar mbi specifikimet teknike

Edhe ky OE nuk ka dorëzuar deklaratën e kërkuar në Dosjen e Tenderit si Deklaratë mbi Specifikacionet Teknike.

Në vend të saj, OE ka dorëzuar vetëm një deklaratë të përgjithshme, ku deklaron: *“Lidhur me tenderin Numri i Prokurimit: TER-025-018-1.2.1. – Titulli Furnizim me Module për PLC - Prodhim-Ritender II, deklarojmë se specifikimi teknik i pajisjes së ofruar është në përputhje me specifikimin e ofruar në tabelën e të dhënave teknike.”*

Kjo deklaratë e përgjithshme nuk është e njëjtë me dokumentin e kërkuar në Dosjen e Tenderit, LPP dhe rregullore dhe, në vetvete, nuk përmban specifikimin teknik të kërkuar për të mundësuar verifikimin e përputhshmërisë së mallrave të ofruara.

Për më tepër, deklarimi i përgjithshëm se produktet janë në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues nuk mund të zëvendësojë dokumentin konkret të kërkuar në FDT, nëse ky dokument është përcaktuar si dokument i detyrueshëm i ofertës.

Për rrjedhojë, edhe oferta e OE NSH “BF Energy” duhet të konsiderohet e papërgjegjshme dhe të eliminohet nga procedura.

III. LIDHUR ME OFERTËN E OE “BAK-ING” SHPK

Edhe OE BAK-ING SHPK rezulton të ketë të njëjtat mangësi thelbësore.

1. Mospërmbushja e kërkesës për përvojën e ngjashme

OE BAK-ING SHPK, në listën e kontratave të paraqitura, nuk ka specifikuar furnizimet konkrete të realizuara në kuadër të kontratave të referuara.

Disa nga referencat e paraqitura janë jashtë periudhës së kërkuar, ndërsa për referencat e tjera, për shkak të mungesës së përshkrimit të furnizimeve të realizuara, nuk mund të konstatohet në mënyrë të qartë nëse ato përmbushin kërkesën për përvojë të ngjashme të përcaktuar në FDT.

Në këto rrethana, nuk mund të konsiderohet e provuar se OE BAK-ING SHPK i përmbush kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Prova 5_Lista e kontratave e dorezuar nga OE BAK ING shpk

2. Mungesa e Deklaratës së kërkuar mbi specifikimet teknike

Edhe ky OE nuk ka dorëzuar dokumentin e kërkuar si Deklaratë mbi Specifikacionet Teknike.

Në vend të tij, ka dorëzuar vetëm deklaratën e përgjithshme: “BAK-ING SHPK deklaron që i plotëson të gjitha kërkesat e kërkuara në dosje. Oferta jonë është në përputhshmëri të plotë me kërkesat teknike sipas ANEX-it 1.”

Një deklaram i përgjithshëm për përmbushjen e kërkesave teknike nuk mund të barazohet automatikisht me dokumentin specifik të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit, si dhe me kërkesat e përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) dhe Udhëzuesin për Prokurimin Publik Nr. 001/2023, të cilat kërkojnë që përputhshmëria teknike të dëshmohet në mënyrë të qartë, të verifikueshme dhe të dokumentuar.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht dorëzimin e Deklaratës mbi Specifikacionet Teknike si pjesë të dokumentacionit të detyrueshëm të ofertës, atëherë duhet të vlerësohet përmbushja e kësaj kërkesë në mënyrë të njëjtë për të gjithë Operatorët Ekonomikë, në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës së hapur të përcaktuar në LPP, si dhe me udhëzimet përkatëse që rregullojnë mënyrën e vlerësimit të specifikimeve teknike.

Për këto arsye, edhe oferta e OE BAK-ING SHPK duhet të konsiderohet e papërgjegjshme dhe të eliminohet.

Prova 6_“Deklarata mbi specifikimet teknike” e dorezuar nga OE BAK Ing shpk

IV. LIDHUR ME PËRGJEGJSHMËRINË TEKNIKE TË OE “BUSINESS PRO” SHPK

Përveç mangësive të evidentuara në aspektin administrativ dhe të aftësisë teknike/profesionale të operatorëve të lartcekur, konsiderojmë se edhe oferta e OE Business Pro SHPK nuk i përmbush kërkesat teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

1. Mospërputhja teknike e artikullit nr. 2 – Ndërprerës industrial i Ethernet-it

Për artikullin nr. 2, “Ndërprerës industrial i Ethernet-it”, OE Business Pro SHPK ka ofruar produktin:

- 6GK5206-2BB00-2AC2, dhe
- 6GK5991-1AF00-8AA0.

Megjithatë, Dosja e Tenderit ka përcaktuar një kërkesë specifike dhe funksionale për kompatibilitetin e pajisjes së ofruar me sistemin ekzistues.

Në mënyrë të qartë, në Dosjen e Tenderit është kërkuar: “Meqenëse pajisjen e kemi për pjesë rezervë dhe ndërprerësin industrial të rrjetit e kemi të instaluar në sistemin ekzistues të kontrollit, atëherë pajisja e ofertuar duhet të jetë plotësisht kompatibel me sistemin ekzistues, duke mos qenë e nevojshme që të bëhet rikonfigurim harduerik i sistemit ose ndryshime tjera për inkuorporimin dhe vënien në punë të ndërprerësit të rrjetit.”

Për më tepër, kërkesa lidhet drejtpërdrejt me pajisjen ekzistuese: SCALANCE X306-1LD FE – 6GK5306-1BF00-2AA3.

Nga dokumentacioni i ofertës së OE Business Pro SHPK nuk rezulton të jetë paraqitur dëshmi teknike zyrtare nga prodhuesi që konfirmon se kombinimi i pajisjeve të ofruara:

1. është zëvendësim i drejtpërdrejtë i pajisjes ekzistuese;
2. është plotësisht kompatibel me sistemin ekzistues;
3. mund të instalohet pa rikonfigurim harduerik;
4. **nuk kërkon ndryshime në infrastrukturën ekzistuese për inkuorporim dhe vënie në punë;** dhe
5. përmbush të gjitha karakteristikat specifike të kërkuara në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit.

Për më tepër, konfigurimi i ndërfaqes optike të pajisjes së ofruar nuk dëshmohet se përputhet me kërkesën e përcaktuar në specifikimin teknik për portë optike 100 Mbit/s SC për single-mode.

Rrjedhimisht, nuk kemi të bëjmë vetëm me një çështje të emërimit të produktit apo me një alternativë të lejueshme, por me një çështje që prek drejtpërdrejt përmbushjen e një kërkesë teknike të detyrueshme të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Në mungesë të dëshmive të mjaftueshme dhe të verifikueshme se pajisja e ofruar përmbush kërkesën e kompatibilitetit të plotë me sistemin ekzistues, oferta e OE Business Pro SHPK nuk mund të konsiderohet teknikisht e përgjegjshme.

Për rrjedhojë, edhe kjo ofertë duhet të eliminohet nga procedura e prokurimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertave dhe kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, konsiderojmë se pranimi dhe vlerësimi i ofertave që nuk kanë dorëzuar dokumentet e kërkuara shprehimisht në FDT, ndërsa në rastin e OE Business Pro SHPK edhe pranimi i një zgjidhjeje për të cilën nuk është dëshmuar përputhshmëria teknike me sistemin ekzistues, do të rezultonte në trajtim jo të njëjtë të Operatorëve Ekonomikë.

Kërkesat e Dosjes së Tenderit duhet të zbatohen në mënyrë të njëjtë dhe të njëtrajtshme ndaj të gjithë pjesëmarrësve, në mënyrë që krahasimi i ofertave të bëhet mbi baza objektive, transparente dhe të verifikueshme.

Në rastin konkret, mangësitë e identifikuar nuk lidhen vetëm me çështje formale, por ndikojnë drejtpërdrejt në aftësinë e Autoritetit Kontraktues për të verifikuar:

- përmbushjen e kërkesave për përvojë të ngjashme;
- përmbushjen e kërkesave teknike dhe profesionale;
- përputhshmërinë e mallrave të ofruara me specifikimet teknike të detyrueshme;
- kompatibilitetin e pajisjeve të ofruara me sistemin ekzistues; dhe
- përmbushjen e dokumenteve të kërkuara shprehimisht në Dosjen e Tenderit, LPP dhe rregulloreve në fuqi.

Prandaj, nëse këto mangësi do të anashkaloheshin në rastin e Operatorëve Ekonomikë të lartcekur, do të krijohesh një standard i ndryshëm i vlerësimit në raport me kërkesat që u janë imponuar të gjithë tenderuesve në Dosjen e Tenderit.

Prandaj, bazuar në këto, kërkojmë nga Ju, që të sillni vendim meritore me të cilin:

1. Aprovoni plotësisht të bazuar ankesën tonë.
2. Obligoni AK- Termokos sh.a që të anulohet vendimin e datës 04.08.2026
3. Obligoni AK – Termokos sh.a që lëndën ta kthejë në rivlerësim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet e shkaktuara me rastin e përgatitjes së Kërkesës për Ri-shqyrtim të Autoritetit Kontraktues dhe Ankesës në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkangjitura

1. Njoftimi për kontratë;
2. Kërkesa për Rishqyrtim dërguar AK përmes Platformës së e-Prokurimit
3. Përgjigja nga AK në Kërkesën për Rishqyrtim
4. Provat 1-6
5. Dëshmia Pagesa e Ankesës në OSHP

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'i dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'i dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.